




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Nr. i Protokollit: 02/Zyrt.

Datë: 5. 9. 2024

F T E S Ë

I/e nderuar/a,

Komuna e Shtimes është në proces të organizimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për projekt buxhetin e vitit 2025. Për këtë qëllim, kryetari i komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu ka themeluar edhe Grupin Punues për përgatitjen e projekt-buxhetit të komunës për vitin 2025.

Me qëllim të sigurimit të gjithë-përfshirjes me theks në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme qytetare, Komuna e Shtimes ka planifikuar organizimin e dëgjimeve buxhetore me këto grupe qytetare, përfshirë: gratë, të rinjtë, studentët, personat me aftësi të kufizuar, pensionistët, komunitetet jo shumicë që jetojnë në komunën e Shtimes.

Andaj, me qëllim të angazhimit aktiv dhe planifikimit të buxhetit të komunës bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Komuna e Shtimes ju fton në këto dëgjime publike buxhetore.

Vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Ora	Vendi
Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësura (gra, të rinj, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar etj).	E enjte, 12 shtator 2024	14:00	Salla e Kuvendit të Komunës
Dëgjimi Publik me Organizata, klubet sportive dhe bizneset	E enjte, 12 shtator 2024	18:00	Salla e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Dëgjimi Publik i Përgjithshëm me qytetarë të komunës së Shtimes	E premte, 13 shtator 2024	18:00	Salla e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Draft-Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2025-2027 mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Informim ose mund ta shkarkoni nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Shtimes, tek linkun: Dëgjimet Publike

Nëse nuk keni mundësi për të marrë pjesë me prezencë fizike në këtë takim, ju lutem që kërkesat, komentet dhe sugjerimet për Projekt-Buxhetin e vitit 2025, t'i dërgoni në këto e-mail adresa: vlor.a.hyseni@rks-gov.net; besnik.ahmeti@rks-gov.net dhe gentiana.b.mehmeti@rks-gov.net.

Ju mirëpresim!

